



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 75-të, të mbajtur më 14.10.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-8043/1 datë 26.08.2022, me pretendimin për zgjidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, **HIDHET POSHTË**.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për faktin se në denoncimin e dorëzuar ka pretendime për pakënaqësi me veprimet e një personi juridik privat dhe nuk ka pretendime apo indice për veprime të paligjshme apo të palejueshme të kryera nga ana e personave zyrtarë gjatë ushtrimit të kompetencave publike dhe detyrave zyrtare.

Lënda me numër 12 -8043/1 të datës 26.08.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, -----, më datë 26.08.2022, është dorëzuar njoftim/denoncim me numrin 12 -8043. /1 datë 26.08.2022, me pretendime për ndërprerje të kontratës për furnizim me energji elektrike nga Shoqata për Tregti dhe Shërbime "-----" Shkupi dhe me kërkesë për tejkalimin e situatës.

Në rastin konkret, bëhet fjalë për zgjidhjen e parakohshme të njëanshme të një kontrate të lidhur me marrëveshje kornizë më datë 18.03.2022 dhe pa paralajmërim për furnizimin me energji elektrike të disa objekteve të sektorit publik, gjë që shkaktoi probleme në funksionimin aktual të tyre, për të cilën ka pasur edhe ndërhyrje gjyqësore, dhe për shkak të pasigurisë së përcaktimit të furnizuesit, si dhe për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë elektrike, është vënë në pikëpyetje kryerja e rregullt e punëve dhe detyrave të NP-së në fjalë.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se njoftimi/denoncimi i dorëzuar i referohet pakënaqësisë me veprimet e një personi juridik privat dhe nuk ka pretendime apo indikacione për veprime të paligjshme ose të palejueshme të kryera nga zyrtarët në ushtrimin e pushtetit publik dhe detyrës zyrtare pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për trajtimin kompetent të lëndës dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

Përgatiti: J.C.
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së
Одобрил: Н.Б., Член на ДКСК

